



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO



**KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS**  
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA - KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

# **BULETINI** **MUJOR**



**Prishtinë, 2025**

Ky edicion i Buletinit pasqyron  
aktivitetet e KPK-së për muajin shkurt të vitit 2025

## Krerët e sistemit prokurorial vizitojnë Prokurorinë e Apelit dhe Prokurorinë Themelore në Ferizaj

Prishtinë, 3 shkurt 2025 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Ardian Hajdaraj, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi dhe Drejtori i Përgjithshëm I Sekretariatit të KPK-së, Sami Istrefi, vizituan Prokurorinë e Apelit dhe Prokurorinë Themelore në Ferizaj, ku janë pritur nga kryeprokurorët Agron Bajrami dhe Burim Çerkini.



Me këtë rast, z. Hajdaraj dhe z. Kelmendi uruan fillimisht z. Bajrami për zgjedhjen e tij në krye të Prokurorisë së Apelit dhe z. Çerkini në krye të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, duke theksuar se kanë përkrahjen e tyre për zbatimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore.

Nga ana tjetër, Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, Agron Bajrami dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Burim Çerkini, falënderuan krerët e sistemit prokurorial për vizitën e tyre, duke informuar ata për proceset aktuale të punës dhe sfidat e identifikuara pas pranimit të detyrave të reja.

Bashkëbiseduesit u pajtuan në takimin e sotëm për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe për krijimin e kushteve sa më të favorshme të punës, zbatimin e planeve të punës dhe angazhimin e shtuar për fuqizimin e sundimit të ligjit në vendin tonë.



## Mbahet Takimi i 262-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 5 shkurt 2025 – Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 262-të, me ç'rast KPK-ja mori vendimet si vijojnë:

- Refuzoi themelimin e Panelit hetimor AD.nr.01/2025 për rastin e një prokurori në Prokurorinë Themelore në Pejë;



- Miratoi Raportin e Komisionit për Administrimin e Prokurorive për trajtimin e rasteve me kryerës të panjohur, me opsionin e tretë dhe ka obliguar Ushtruesin e Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për nxjerrjen e një vendimi të detyrueshëm për zbatimin e këtij raporti;



- Aprovoi kërkesën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe mori vendim për shpalljen e konkursit për avancim të prokurorëve për dy pozita: një (1) në Departamentin për të Mitur dhe një (1) në Departamentin për Krime të Rënda;
- Diskutoi kërkesën e Koordinatorës Nacionale për Zgjedhje dhe mori vendim që e njëjta t'i dërgohet për shqyrtim Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel;
- Njoftoi për pensionimin e prokurores së Prokurorisë së Apelit, znj. Bedrije Sylja - Alshiqi, për të cilën do të dërgojë propozimin në Zyrën e Presidentes për lirim nga detyra me rastin e pensionimit të saj;
- Miratoi propozimin e Kryeprokurores së Prokurorisë Themelore në Pejë për caktimin e znj. Arlinda Nallbani - Gacaferri në detyrën e Zëvendëskryeprokurores së kësaj prokurorie;
- Miratoi marrëveshjen vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore në rastin AD.nr.6/2024-I.

## Drejtori i Përgjithshëm, Sami Istrefi, priti në takim Drejtorin për Siguri dhe Emergjencë në Komunën e Prishtinës, Lulzim Fushtica

Prishtinë, 6 shkurt 2025 - Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (SKPK), Sami Istrefi, priti në takim Drejtorin për Siguri dhe Emergjencë në Komunën e Prishtinës, Lulzim Fushtica, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, Këshilltarin për Çështje të Sigurisë, Bajram Gecaj dhe Ekspertin e Jashtëm për Menaxhimin e Pronave, Andi Bytyqi.



Fillimisht, z. Istrefi falënderoi z. Fushtica për vizitën e tyre, duke shprehur përkushtimin dhe gatishmërinë e tij për bashkëpunim lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe kompetencat e të dyja palëve.

Me këtë rast, z. Fushtica dhe bashkëpunëtorët e tij, parashtruan kërkesën për shqyrtimin e mundësisë që objekti i tanishëm i Prokurorit të Shtetit, i cili është në pronësi të Komunës së Prishtinës, të lirohet për vendosjen e Policisë së Kryeqytetit, e cila është themeluar me ligj.

Nga ana tjetër, Drejtori Istrefi njoftoi përfaqësuesit e Komunës së Prishtinës se kjo kërkesë është e vështirë për t'u realizuar, ngaqë sistemi prokurorial është duke u ballafaquar me mungesë të madhe të hapësirave dhe gjatë vitit 2025 është planifikuar të investohet në objektin e Prokurorit të Shtetit për nevojat e akomodimit të stafit përkatës profesional dhe administrativ të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Z. Istrefi dhe z. Fushtica u pajtuan që të vazhdojnë konsultimet e tyre në të ardhmen për zgjidhjen adekuate të kësaj çështjeje.



## Komisioni për Çështje Normative finalizoi një draftregullore dhe themeloi dy grupe punuese për hartimin e dy akteve nënligjore

Prishtinë, 7 shkurt 2025 – Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i kryesuar nga z. Armend Zenelaj, mbajti takimin e radhës sipas agjendës së paraparë, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij Komisioni, z. Bahri Hyseni dhe z. Ilir Morina dhe anëtarët e KPK-së, z. Veton Shabani dhe z. Visar Krasniqi, si dhe Zëvendëskryeprokurori i Prokurorisë Speciale, z. Valdet Gashi, njëherësh kryesues i Grupit punues për hartimin e draftit të Rregullores për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipeve të Përbashkëta të hetimit dhe përfaqësuesja e projektit nga Ambasada Britanike në Prishtinë, znj. Albulena Ukimeri.



Më këtë rast, anëtarët e këtij komisioni finalizuan draftin e Rregullores për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit, draft ky, i cili do të procedohet për miratim në takimin e radhës së KPK-së.

Një vendim tjetër që morën sot anëtarët e Komisionit për Çështje Normative ishte themelimi i Grupit punues për hartimin e draftit të Udhëzimit Administrativ për Caktimin e Normës Orientuese dhe themelimin e Grupit punues për hartimin e draftit të Rregullores për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve.

## Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel aprovoi Raportin vjetor financiar për vitin 2024 dhe Planin e punës për vitin 2025

Prishtinë, 10 shkurt 2025 – Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), i udhëhequr nga prokurorja Ariana Shajkovci, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë: anëtarët e Komisionit, anëtari i KPK-së, Visar Krasniqi, Koordinatori për Komisionet e Përherëshme të KPK-së, Besim Kusari, Udhëheqësja e Departamentit për Buxhet dhe Financa në Sekretariatit të KPK-së, Suzana Pllana dhe Udhëheqësja e Divizionit për Financa, Nora Qerkezi.



Gjatë takimit të sotëm, anëtarët e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel aprovuan Raportin vjetor financiar për vitin 2024 dhe Planin e punës për vitin 2025 me plotësim ndryshimet e propozuara.

Gjithashtu u trajtua edhe kërkesa e Koordinatorës Nacionale për Zgjedhje për ndarjen e mjeteve buxhetore për prokurorët që kanë qenë kujdestarë në ditën e zgjedhjeve parlamentare, më 9 shkurt, në kuadër të projektit strategjik “Mbrotjtja e votës” të Prokurorit të Shtetit.

## **Mbahet punëtori për finalizimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial për vitet 2025-2027**

Prishtinë, 13 shkurt 2025 – Këshilli Prokurorial i Kosovës, gjegjësisht, Grupi punues për hartimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2025-2027, i udhëhequr nga Zëvendëskryesuesja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, znj. Jehona Grantolli, ka organizuar një punëtori dyditore për finalizimin e Planit strategjik dhe Planit të veprimit të sistemit prokurorial për vitet 2025-2027.

Të pranishëm në këtë punëtori, krahas anëtarëve të grupit punues, janë edhe Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, anëtarë të KPK-së, prokurorë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorë dhe prokurorë të prokurorive të vendit, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, z. Sami Istrefi dhe stafi administrativ.



Fillimisht, gjatë zhvillimit të sesionit të parë të kësaj punëtorie, znj. Grantolli, falënderoi përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë, konkretisht Ambasadën Amerikane, për ofrimin e ndihmës për hartimin e draftit kryesor me anë të ekspertëve të tyre në punëtorinë e kaluar. “Ky plan strategjik që është në finalizim e sipër do të ndihmojë sistemin prokurorial në planifikimin dhe orientimin e qartë, me qëllim të përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies së sistemit prokurorial”, tha znj. Grantolli.

Gjatë fjalës së tyre, edhe Kryesuesi Hajdaraj dhe Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, theksuan rëndësinë e madhe të definimit të objektivave, nënobjektivave, planifikimin e veprimeve dhe

aktiviteteve konkrete të sistemit prokurorial, që do të shërbejnë për forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Gjithashtu, pjesëmarrësit e tjerë të punëtorisë, diskutuan për çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen e pavarësisë, paanshmërinë, dhe funksionimin e sistemit prokurorial dhe ngritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në trajtimin e rasteve të veprave penale.

Kjo punëtori do të vazhdojë edhe gjatë ditës së nesërme dhe pas finalizimit të tërësishëm të Planit strategjik dhe Planit të veprimit të sistemit prokurorial për vitet 2025-2027 do të dërgohet për miratim në KPK.



## Kryesuesi Ardian Hajdaraj priti në takim Ambasadorën e Holandës në Prishtinë, Karin Boven

Prishtinë, 18 shkurt 2025 - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, i shoqëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, z. Sami Istrefi, priti në takim Ambasadorën e Holandës në Prishtinë, znj. Karin Boven.

Në fillim të takimit, Kryesuesi Hajdaraj e përshëndeti Ambasadorën Boven për emërimin e saj në detyrën e re, duke i shprehur mirënjohjen e tij për mbështetje dhe kontributin e vazhdueshëm të shtetit të Holandës në forcimin e sistemit prokurorial në Kosovë.



Kryesuesi Hajdaraj, theksoi vullnetin dhe përkushtimin e tij të madh për të zhvilluar dhe thelluar partneritetin e përbashkët në fushat përkatëse, si dhe për të avancuar dhe fuqizuar rendin dhe sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës, me mbështetje të vazhdueshme nga Holanda dhe partnerët ndërkombëtarë.

Nga ana tjetër, Ambasadorja e Holandës, Karin Boven, ka falënderuar Kryesuesin Hajdaraj për pritjen, si dhe ka potencuar se shteti i saj është i gatshëm të mbështesë fuqizimin e sistemit prokurorial në Kosovë, duke theksuar rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit të ngushtë dhe të efektshëm mes institucioneve të Kosovës dhe të Holandës për arritjen e objektivave të përbashkëta.

## Reagim i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për sulmin ndaj prokurorit Ramiz Buzhala

Prishtinë, 20 shkurt 2025 - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) dënojnë ashpër sulmin e sotëm fizik ndaj prokurorit të Departamentit të Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Pejë, z. Ramiz Buzhala, sulm ky, i cili ndërlidhet me punën e tij zyrtare.

KPK-ja dhe ZKPSH-ja, theksojnë se aktet e tilla ndaj prokurorëve janë të patolerueshme dhe qëndrojnë fuqishëm pranë prokurorit Buzhala, duke e mbështetur në punën e tij të përditshme dhe duke e inkurajuar për përmbushjen e misionit të tij ligjor.

Gjithashtu, KPK dhe ZKPSH, me këtë rast, nënvizojnë se, aktet e tilla nuk mund të ndikojnë që prokurori Buzhala të zbrapset nga ndjekja e kryeseve të veprave penale dhe do të vazhdojë punën e tij, për të cilën e obligojnë Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës.



Këto dy institucione të sistemit prokurorial, sigurojnë opinionin publik se sulmi ndaj prokurorit Ramiz Buzhala është duke u trajtuar me prioritet nga organet kompetente dhe ndaj sulmuesit është marrë vendim për ndalimin e tij për 48 orë dhe janë duke u ndërmarrë hapat e mëtutjeshëm ligjorë.

## Mbahet Turneu Memorial i Futbollit kushtuar prokurorit Enver Krasniqi

Prishtinë, 22 shkurt 2025 – Këshilli Prokurorial i Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës organizoi Turneun Memorial të Futbollit kushtuar prokurorit të ndjerë, Enver Krasniqi, në të cilin morën pjesë Kryesuesi Hajdaraj, Kryeprokurori Isufaj, kryeprokurorë dhe prokurorë të prokurorive themelore, si dhe stafi administrativ i sistemit prokurorial.



Gjithashtu ia vlen të theksohet se në këtë turne morën pjesë 10 ekipe me gjithsej 90 lojtarë pjesëmarrës nga KPK-ja, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokuroria Speciale, prokuroritë themelore dhe Policia e Kosovës, e cila zhvilloi një ndeshje revyale në shenjë nderimi për prokurorin Enver Krasniqi.



Më këtë rast, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Kosovës, Blerim Isufaj, ka theksuar se qëllimi i mbajtjes së këtij turneu sportiv është përkujtimi i një prokurori special të dalluar, i cili gjatë karrierës së tij profesionale ka dhënë kontribut të çmuar, duke lënë gjurmë të pashlyera në sistemin e drejtësisë. “Prokurori Enver Krasniqi ishte adhures i madh i sportit dhe ishte një njeri me integritet, që donte familjen dhe shoqërinë, andaj më e pakta që mund të bëjmë është ta përkujtojmë me një aktivitet sportiv”, ka thënë z. Isufaj me këtë rast.



Në shenjë mirënjohjeje dhe respekti ndaj punës së prokurorit Krasniqi, i cili ka ndërruar jetë para katër vjetëve, familjes Krasniqi iu ndanë një mirënjohje dhe kupa ceremoniale e turneut, kurse ekipit fitues nga Prokuroria Themelore e Prishtinës iu ndanë medaljet dhe kupa e turneut, si dhe ekipit që zuri vendin e dytë nga Prokuroria Themelore e Prizrenit iu ndanë medaljet.



Kjo ngjarje sportive e sistemit prokurorial do të vazhdojë të mbahet edhe viteve të ardhshme dhe do të jetë tradicionale.





## KPK-ja diskuton me përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë dhe të shoqërisë civile për konceptin e Planit strategjik të sistemit prokurorial për vitet 2025-2027

Prishtinë, 24 shkurt 2025 – Këshilli Prokurorial i Kosovës, përkatësisht Grupi punues për hartimin e Planit strategjik dhe Planit të veprimit për vitet 2025-2027, i cili udhëhiqet nga Zëvendësja e Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, znj. Jehona Grantolli, ka organizuar një takim me përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë dhe të shoqërisë civile për të diskutuar për konceptin e këtij draftdokumenti të rëndësishëm strategjik të sistemit prokurorial.



Më këtë rast, znj. Jehona Grantolli, falënderoi për pjesëmarrjen e tyre përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë dhe të shoqërisë civile, duke theksuar se mirëpret në mënyrë të veçantë diskutimin e sotëm dhe komentet e tyre për draftin e Planit strategjik dhe Planit të veprimit për vitet 2025-2027, si dhe informoi të pranishmit për kontributin e Ambasadën Amerikane në Prishtinë dhënë hartimit të draftit kryesor me anë të ekspertëve të saj.



Gjithashtu, pjesëmarrësit vlerësuan draftin e përgatitur nga ana e Grupit punues, duke potencuar se mbështesin ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe avancimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit në Kosovë, duke ruajtur pavarësinë, paanshmërinë dhe funksionimin e sistemit prokurorial.

Në përmbyllje të takimit është theksuar se do të ketë edhe takime të tjera në rrjedhën e finalizimit të plotë të këtij dokumenti strategjik dhe dërgimin e tij për miratim në njërën nga takimet e radhës së KPK-së.

## Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 25 shkurt 2025 - Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët Bahri Hyseni dhe Ilir Morina, si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, Sami Istrefi, përfaqësuesi i Zyrës së BE-së në Prishtinë, Mats Persson, Koordinator i Komisioneve të Përhershme të KPK-së, Besim Kusari dhe Udhëheqësja e Departamentit Ligjor në SKPK, Saranda Sokoli.



Më këtë rast është finalizuar drafti i Rregullores për Plotësimin e Rregullores Nr.02\2023 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës së Këshillit Prokurorial të Kosovës, draft ky, i cili do të procedohet për miratim në njërin nga takimet e radhës së KPK-së.



Gjithashtu gjatë takimit të sotëm janë trajtuar dy draftanaliza për themelimin e dy komisioneve të reja dhe për të cilat ka pasur pajtim që të njëjtat të procedohen në KPK për trajtim të mëtutjeshëm të tyre.

## Mbahet takimi i radhës I Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Prishtinë, 25 shkurt 2024 – Komisioni për Administrim të Prokurorive, i kryesuar nga Jetish Maloku, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarja Laura Pula, Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti, administratorët e prokurorive të vendit dhe stafi administrativ i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.



Në këtë takim është diskutuar për shkëmbimin elektronik të të dhënave ndërmjet Prokurorisë dhe Policisë, me ç'rast është vendosur që të formohet një grup punues, i cili do të paraqesë rekomandimet për avancimin e sistemeve përkatëse të të dhënave, me qëllim që tërë komunikimi të bëhet në formë elektronike nga Prokuroria dhe anasjelltas.



Po ashtu, ky grup punues do të përgatisë edhe një draftudhëzues për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet këtyre dy institucioneve.

## Komisioni për Administrimin e Prokurorive miratoi analizat për numrin e nevojshëm të prokurorëve në Mitrovicë dhe Prizren

Prishtinë, 26 shkurt 2024 – Komisioni për Administrimin e Prokurorive, i kryesuar nga Jetish Maloku, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarja: Laura Pula, si dhe Drejtoresha e NJSHPP-së, Arta Kelmendi, Koordinator i Komisioneve të Përhershme të KPK-së, Besim Kusari dhe Udhëheqësi i Departamentit të Teknologjisë Informative në SKPK, Nexhat Haziri dhe stafi administrativ i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.



Në takimin e sotëm është trajtuar analiza për numrin e nevojshëm të prokurorëve në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë dhe analiza tjetër për numrin e nevojshëm të prokurorëve në Prokurorinë Themelore në Prizren, me ç'rast të njëjtat janë aprovuar dhe do të dërgohen për miratim në njërin nga takimet e Këshillit Prokurorial të Kosovës.



## **Drejtori i Përgjithshëm, Sami Istrefi, mori pjesë në ceremoninë e rrjetëzimit të zyrtarëve publikë në Programin e trajnimeve për sundimin e ligjit në Ambasadën e Holandës në Prishtinë**

Prishtinë, 27 shkurt 2025 –Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, Sami Istrefi, ka marrë pjesë në ceremoninë e organizuar nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Prishtinë për shënimin e rrjetëzimit të zyrtarëve publikë të institucioneve të Republikës së Kosovës në Programin e trajnimeve për sundimin e ligjit.



Më këtë rast, Ambasadorja e Mbretërisë së Holandës në Prishtinë, znj. Karin Boven, në fjalën e saj të rastit, theksoi rëndësinë e ngritjes së kapaciteteve të institucioneve kosovare, duke u shprehur e lumtur që sonte ka dëgjuar nga pjesëmarrësit për ndikimin e këtij programi në punën e tyre.



Gjatë diskutimeve të pjesëmarrësve, z. Istrefi shprehu falënderimin e tij për përkrahjen dhe mbështetjen e Ambasadës së Holandës, me ç'rast pjesë e rrjetëzimit të këtij programi trajnues ishin edhe zyrtaret e sistemit prokurorial, znj. Besarta Zuka, znj. Verona Kadriu dhe znj. Doruntina Ismajli.

Ky program i trajnimit në fushën e sundimit të ligjit do të vazhdojë deri në vitin 2027.



